

LIGJ¹
Nr. 75/2014

PËR SHËRBIMIN PRIVAT TË SIGURISË FIZIKE
(ndryshuar me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka si qëllim rregullimin e veprimtarisë së shërbimit privat të sigurisë fizike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Objekti i ligjit

Objekt i këtij ligji janë:

- a) sigurimi fizik i objekteve shtetërore dhe private, i personave, si dhe i veprimtarive social-kulturore sportive, fetare e politike;
- b) sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, materiale dhe i sendeve të çmuara gjatë transportit.

Neni 3
Përkufizime

(ndryshuar pikat 4, 18, 20 ; shtuar pikat 16/1, 23/1, 26/1, 28, 29 ; shfuqizuar pikat 19, 21, me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Besueshmëria” është procesi i verifikimit të të dhënave të individit në raport me ato të regjistrave fizikë dhe elektronikë të të gjitha institucioneve shtetërore.
2. “Certifikatë” është dokumenti, që i jepet titullarit të subjektit, drejtuesit teknik dhe punonjësit të shërbimit, i cili vërteton aftësinë e tyre për ushtrimin e detyrave përkatëse.
3. “DPPSH” është Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
4. “DVP” është Drejtoria Vendore e Policisë.
5. “Drejtues teknik” është menaxheri më i lartë teknik për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e këtij shërbimi.

¹ Ligji nr. 90/2023, datë 2.11.2023 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.174, datë 4.12.2023.

6. “KSHA” është Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, i ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe drejtorinë e policisë së qarkut për vlerësimin dhe shqyrtimin e ankesave në lidhje me shërbimin e SHPSF-ve.

7. “KSHKC” është komisioni i shqyrtimit të kërkesave për certifikim të punonjësve të shërbimit, në drejtorinë e policisë së qarqeve.

8. “KSHKCL” është Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim dhe Licencim, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

9. “Licencë” është akti administrativ që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë të ushtrojë tipin e veprimtarisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

10. “Ministri” është ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

11. “Objekti në sigurim” janë personat, objektet e hapura dhe të mbyllura ku ushtrohet shërbimi privat i sigurisë fizike.

12. “Pajisjet e shërbimit” janë pajisjet e miratuara sipas akteve ligjore e nënligjore të nevojshme për përmbushjen e detyrës.

13. “Pajisjet elektronike” janë pajisjet audio dhe video që përdoren në funksion të qëllimit të këtij ligji.

14. “Palët” janë subjektet që hyjnë në marrëdhënie kontraktuale për veprimtarinë e sigurisë fizike.

15. “Përdorimi i armës” është e drejta që i jepet punonjësit të këtij shërbimi për të përdorur armët e zjarrit, në zbatim të ligjit në fuqi.

16. “Përdorimi i forcës” është e drejta që i jepet punonjësit të këtij shërbimi për përdorimin e forcës fizike, si dhe për përdorimin e pajisjeve të shërbimit, gjatë përmbushjes së detyrës.

16/1. “Përgjegjësi i shërbimit” është punonjësi i shërbimit i caktuar në detyrë nga titullari i subjektit pas kryerjes së trajnimit të specializuar dhe ka për detyrë planifikimin, organizimin dhe kontrollin e shërbimit për një objekt ose grup objektesh.

17. “Punonjësi i shërbimit” është shtetasi i certifikuar në fushën e shërbimeve private të sigurisë fizike.

18. “Qendra e Menaxhimit të Shërbimeve (QMSH)” është ambienti i kompletuar me personel të specializuar, mjete dhe pajisje elektronike, që shërben për menaxhimin dhe monitorimin e veprimtarisë së sigurisë fizike.

19. Shfuqizuar

20. “QKB” është Qendra Kombëtare e Biznesit.

21. Shfuqizuar

22. “Standarde profesionale” është tërësia e rregullave dhe akteve normative në fuqi, të detyrueshme për t’u zbatuar nga subjektet e licencuara për shërbimin privat të sigurisë fizike.

23. “SHPSF (shërbimi privat i sigurisë fizike)” është shërbimi që ofrohet nga subjekti privat i licencuar për sigurimin e objekteve shtetërore, private, personave, si dhe të veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare, të vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, në bazë të detyrimeve kontraktuale.

23/1. “QTP (Qendra e Trajnimit Privat)” është subjekti i licencuar që ofron trajnime të punonjësve të shërbimit privat të sigurisë fizike.

24. “Titullar i licencës” është personi juridik që ka marrë një licencë.

25. “Titullar i subjektit” është përfaqësuesi ligjor i subjektit.

26. “Trajnimi” është procesi i edukimit tekniko-profesional për kryerjen e shërbimit të sigurisë fizike.

26/1. “Trajner” është specialisti për trajnimin e punonjësve të SHPSF-së, i kualifikuar dhe i certifikuar nga institucioni arsimor përgjegjës për arsimin, formimin dhe trajnimin e punonjësve të Policisë së Shtetit.

27. “Vërtetimi i besueshmërisë” është akti administrativ i organit përgjegjës të Policisë së Shtetit, ku dokumentohet procesi i verifikimit të besueshmërisë.

28. “Vlerësimi i riskut” është procesi i mbledhjes dhe analizimit të informacioneve dhe të dhënave për identifikimin e rreziqeve të mundshme për jetën dhe shëndetin e personave, të cilët kërkojnë mbrojtje fizike të afërt apo trupore.

29. “Zyra e menaxhimit të shërbimit” është ambienti i kompletuar me pajisjet e nevojshme, që shërben për mbajtjen, administrimin e dokumentacionit, armatimit e pajisjeve të tjera të shërbimit dhe për instruktimin e punonjësve të shërbimit.

KREU II CERTIFIKIMI DHE LICENCIMI

Neni 4

Parime të përgjithshme

Subjektet e SHPSF-së, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre u nënshtrohen parimeve të përgjithshme, si parimi respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, i mosdiskriminimit, i ligjshmërisë, i profesionalizmit, objektivitetit dhe të detyrimit për të parandaluar konfliktin e interesit.

Neni 5

Certifikimi

(shtuar fjalë në pikën 1, ndryshuar pika 5 dhe 6, shfuqizuar pika 7 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Certifikimi i titullarit dhe i drejtuesit teknik të SHPSF-së dhe QTP-së është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Certifikimi i punonjësit të shërbimit është kompetencë e drejtorit të policisë së qarkut.

3. Vendimet e certifikimit, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, lëshohen duke u bazuar respektivisht në mendimin paraprak të KSHKCL-së dhe KSHKC-së.

4. Pajisja me certifikatë e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik bëhet brenda 45 ditëve, ndërsa për punonjësën e shërbimit bëhet brenda 30 ditëve nga dita e plotësimit të formularit të kërkesës për aplikim.

5. Certifikata për titullarin e subjektit, për drejtuesin teknik dhe punonjësën e shërbimit është e vlefshme për 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje.

6. Ngritja, funksionimi, kompetencat, përbërja e komisionit dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesave për certifikim/licencim rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin e sigurinë publike.

7. shfuqizuar

Neni 6

Licencimi

(shtuar fjalë në pikën 1, ndryshuar pika 2 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Licencimi i subjekteve të SHPSF-ve dhe QTP-ve bëhet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit publikon në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve vendimin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit për miratimin, refuzimin dhe shfuqizimin e licencës, bazuar në propozimin e KSHKCL-së.

3. Licenca është pa afat.

Neni 7

Kategoritë e licencës

(ndryshuar paragrafi 1, shtuar pika c me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

Licencat sipas këtij ligji ndahen në tre nënkategori:

- a) nënkategoria I.3.A, “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike”, i cili ushtrohet në të gjithë territorin e vendit;
- b) nënkategoria I.3.B, “Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare e sendeve të çmuara gjatë transportit”, i cili ushtrohet në të gjithë territorin e vendit.
- c) nënkategoria I.3.C, “Trajnimi privat i punonjësve të SHPSF-së”, e cila ushtrohet në të gjithë territorin e vendit.

Neni 8

E drejta e përfitimit njëkohësisht të nënkategorive të licencës

(shtuar fjalë me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

Çdo subjekt ka të drejtë të përfitojë njëkohësisht licencën e nënkategorisë I.3.A, I.3.B dhe I.3.C, me kusht që për secilën nënkategori të ketë drejtues teknik më vete.

Neni 9

Llojet e certifikatave

(ndryshuar pika 1 dhe 2 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

- 1. Certifikatat për titullarin dhe drejtuesin teknik të SHPSF-së dhe QTP-së jepen sipas nënkategorive të licencës I.3.A, I.3.B dhe I.3.C.
- 2. Certifikatat për punonjës të shërbimit të SHPSF-së jepen sipas nënkategorive të licencës I.3.A, I.3.B.

Neni 10

Kriteret për certifikimin e titullarit

(ndryshuar shkronja c me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

Pajiset me certifikatën e titullarit të SHPSF-së personi që plotëson këto kriterë:

- a) të jetë me arsim të mesëm, të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- b) të përmbushë kriterin e besueshmërisë, sipas kuptimit që i jep ky ligj, si dhe të ortakëve të tij në rast se ka;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje.

Neni 11

Kriteret për certifikimin e drejtuesit teknik

(shfuqizuar shkronja a e pikës 1 dhe pika 2, ndryshuar shkronjat ç, dh dhe e të pikës 1 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

- 1. Pajiset me certifikatën e drejtuesit teknik personi që plotëson këto kriterë:

- a) shfuqizuar;
- b) të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;

c) të ketë aftësi fizike e mendore për të kryer detyrën, të vërtetuar me raportin mjekësor nga komisioni përkatës;

ç) të jetë me arsim të lartë dhe të ketë mbi 3 vjet përvojë pune në funksione të nivelit menaxhues në institucionet shtetërore të sigurisë dhe mbrojtjes.

d) të përmbushë kriterin e besueshmërisë, sipas kuptimit që i jep ky ligj;

dh) të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje.

e) të mos jetë shkarkuar nga detyra për shkaqe disiplinore në 3 vjetët e fundit nga data e kërkesës.

2. shfuqizuar

Neni 12

Kriteret për certifikimin e punonjësit të shërbimit

(shfuqizuar shkronja ç e pikës 1, ndryshuar pikat ç, e dhe ë me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Pajiset me certifikatën e punonjësit të shërbimit personi që plotëson këto kriteret:

a) të ketë mbushur moshën 18 vjeç;

b) të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;

c) të ketë aftësi fizike e mendore për të kryer detyrën, të vërtetuar me raportin mjekësor nga komisioni përkatës;

ç) shfuqizuar;

d) të ketë përfunduar arsimin bazë;

dh) të përmbushë kriterin e besueshmërisë, sipas kuptimit që i jep ky ligj;

e) të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje;

ë) të mos jetë shkarkuar nga detyra për shkaqe disiplinore në 3 vjetët e fundit nga data e kërkesës.

f) të ketë kryer, në qendrën e trajnimit të licencuar, kursin e nevojshëm profesional dhe të jetë pajisur me dëshminë përkatëse.

2. Kur personi që kërkon të pajiset me certifikatën e punonjësit të shërbimit të sigurisë fizike është ish-punonjës i Policisë së Shtetit apo i strukturave të tjera ligjzbatuese, me gradë policore e ushtarake, nuk kryen kursin e nevojshëm profesional dhe testimin.

Neni 13

Certifikimi i shtetasve të huaj

(ndryshuar me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Shtetasi i huaj gëzon të drejtën të certifikohet si titullar i subjektit nëse plotëson, përveç kriterëve të veçanta të përcaktuara në këtë ligj, edhe kriteret e mëposhtme:

a) të jetë i pajisur me leje unike sipas parashikimeve të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”;

b) të përmbushë kriterin e besueshmërisë sipas kuptimit të këtij ligji.

2. Shtetasi i huaj gëzon të drejtën të certifikohet si drejtues teknik dhe punonjës shërbimi i subjektit nëse plotëson, përveç kriterëve të veçanta të përcaktuara në këtë ligj, edhe kriteret e mëposhtme:

a) të jetë i pajisur me leje unike sipas parashikimeve të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”;

b) të marrë miratimin paraprak nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;

c) të përmbushë kriterin e besueshmërisë sipas kuptimit të këtij ligji.”.

Neni 14

Kriteret për licencim

(ndryshuar me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Për pajisjen me licencë të nënkategorive 1.3.A, 1.3.B dhe 1.3.C subjekti duhet të plotësojë këto kriteret:

- a) të jetë i regjistruar në QKB si sh.a., ose sh.p.k., dhe të ketë përcaktuar më parë drejtuesin teknik për nënkategorinë që do të licencohet;
- b) titullari i subjektit të jetë i pajisur me certifikatën e nënkategorisë për të cilën do të licencohet;
- c) drejtuesi teknik të jetë i pajisur me certifikatën e nënkategorisë së subjektit ku do të punësohet, si dhe të jetë punësuar me kohë të plotë pune në subjektin e SHPSF-së/QTP-së;
- ç) të jetë lidhur kontratë pune ndërmjet titullarit dhe drejtuesit teknik.”.

2. Për nevoja të veçanta pune ose në rastet e ushtrimit të aktivitetit të SHPSF-së në territorin e mbi 3 qarqeve dhe me mbi 300 punonjës shërbimi, subjekti mund të punësojë më shumë se një drejtues teknik për secilën nënkategori licence.

3. Dokumentet provuese për përmbushjen e kriterëve për ushtrimin e aktivitetit 1.3.A, 1.3.B, 1.3.C, si dhe për punësimin e më shumë se një drejtuesi teknik përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 15

Refuzimi për dhënien e certifikatës dhe të licencës

1. Refuzimi i kërkesës për pajisjen me certifikatë të titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik bëhet me vendim të arsyetuar të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit publikon në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve vendimin e refuzimit të kërkesës për licencim.

3. Refuzimi i kërkesës për pajisjen me certifikatë për punonjës shërbimi bëhet me vendim të arsyetuar të drejtorit të policisë së qarkut.

Neni 16

E drejta e ankimit

(ndryshuar pika 5 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Ankimi ndaj vendimit të refuzimit për pajisjen me certifikatë të titullarit të subjektit, drejtuesit teknik dhe punonjësit të shërbimit bëhet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit të refuzimit në komisionin e shqyrtimit të ankesave (KSHA), sipas përkatësisë.

2. Ankimi ndaj vendimit të refuzimit të dhënies dhe revokimit të licencës bëhen sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Komisioni i shqyrtimit të ankesave bën shqyrtimin e ankimeve brenda 30 ditëve, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

4. Përbërja, kompetencat, si dhe procedurat e funksionimit të komisionit të shqyrtimit të ankesave përcaktohen me udhëzim të ministrit.

5. Ankimi ndaj vendimit të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit për refuzimin ose shfuqizimin e certifikatës dhe licencës pas shqyrtimit të ankimit administrativ bëhet në gjykatën administrative.

Neni 17

Ripërtëritja e afatit të certifikatës

(ndryshuar pikat 1, 2, 3 dhe 6 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Ripërtëritja e afatit të certifikatës për titullarin e subjektit dhe drejtuesin teknik të SHPSF-së dhe QTP-së, si dhe punonjës in e shërbimit të SHPSF-së bëhet me mbarimin e afatit 5-vjeçar nga koha e dhënies së saj.
2. Kërkesa për ripërtëritjen e certifikatës bëhet 90 ditë kalendarike para datës së përfundimit të afatit.
3. Ripërtëritja e certifikatës bëhet pasi rishqyrtohen kriteret e certifikimit sipas kërkesave të këtij ligji.
4. Në rastin e ripërtëritjes, certifikata jepet brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj.
5. Mosparaqitja e kërkesës për ripërtëritje, nga ana e subjektit të shoqërisë, brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj, sjell mosripërtëritjen e certifikatës.
6. Mosripërtëritja e certifikatës nuk e heq të drejtën e kërkesës për pajisje me certifikatë të re.

KREU III

MARRËDHËNIET NDËRMJET PALËVE

Neni 18

Kontrata ndërmjet palëve

(ndryshuar pika 2; shtuar pikat 3 dhe 4 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Palët lidhin kontratë, ndërmjet tyre, për kryerjen e shërbimit për ushtrimin e veprimtarisë private të sigurisë fizike, e cila duhet të përmbajë:
 - a) nënkategorinë e licencës;
 - b) drejtuesin teknik;
 - c) objektin konkret në ruajtje;
 - ç) rregullat për regjimin e hyrjes dhe daljes, të ndriçimit, të rrethimit, të mjeteve vëzhguese e sinjalizuese;
 - d) numrin e vendrojavë dhe të punonjësve të shërbimit, sipas koeficientit të llogaritjes për 40 orë pune në javë për një punonjës shërbimi.Për objekte të rëndësishme me vlera monetare, materiale e rrezikshmëri për sigurinë publike, përcaktimi i skemës së sigurisë së objektit bëhet me miratim të Policisë së Shtetit;
 - dh) llojin e armatimit, të pajisjeve dhe të mjeteve të shërbimit;
 - e) llojin e uniformës, simbolet, shenjat dalluese;
 - ë) detyrimet financiare midis tyre, në raste të shkaktimit të dëmit;
 - f) detyrat dhe të drejtat e palëve, afatin e lidhjes së kontratës, si dhe mënyrat e zgjidhjes së saj.
 - g) paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50 për qind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
 - gj) Subjektet publike dhe jopublike, të cilat administrojnë objekte social-ekonomike me vlerë të madhe financiare, me qëllim garantimin e sigurisë së jetës, sigurisë fizike të objekteve, detyrohen të lidhin kontratë me shërbimin privat të sigurisë fizike.Kriteret për përcaktimin e këtyre objekteve bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Nënkontraktimi i kësaj veprimtarie lejohet vetëm duke respektuar të njëjtat kushte dhe kriteret të pranura në kontratën bazë të SHPSF-së. Subjektet e SHPSF-së për kontratat e lidhura për

shërbimin e nënkontraktuar informojnë brenda 30 ditëve strukturat vendore të Policisë së Shtetit, duke dorëzuar një kopje të kontratës bazë dhe asaj të nënkontraktuar. Lidhur me detyrimin për njoftimin mbi kontratat e reja për shërbimin e nënkontraktuar, subjekti i SHPSF-së ruan të drejtën për të mos njoftuar strukturën vendore për çmimin e kontratës së lidhur.

3. Subjektet e SHPSF-së, që ushtrojnë veprimtari të ruajtjes së personave fizikë/juridikë përpara lidhjes së kontratës së shërbimit paraqesin kërkesë me shkrim për miratim pranë Drejtorisë Vendore të Policisë për kryerjen e vlerësimit të riskut të subjektit që kërkon ruajtje të afërt. Në rast se Drejtoria Vendore e Policisë pas vlerësimit të riskut vendos refuzimin e kërkesës, subjekti ka të drejtë të paraqesë ankim pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

4. Ngritja, funksionimi dhe përbërja e komisionit të vlerësimit të riskut, si dhe formati i vlerësimit të riskut përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 19

Mbikëqyrja e veprimtarisë së SHPSF-ve (*shtuar fjalë me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023*)

Mbikëqyrja e veprimtarisë së SHPSF-ve dhe QTP-ve i nënshtrohet inspektimit të rregullt nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit, gjatë të cilit zbatohet legjislacioni në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20

Kompetencat mbikëqyrëse (*shtuar fjalë në pikën 1; ndryshuar shkronjat a dhe b; hequr fjalë në shkronjën dh me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023*)

1. Strukturat e Policisë së Shtetit kanë këto kompetenca për mbikëqyrjen e veprimtarisë së SHPSF-së dhe QTP-së :

- a) kryejnë monitorimin nëpërmjet dokumentacionit për aktivitetin e shoqërive të sigurisë fizike dhe qendrave të trajnimit të punonjësve të SHPSF-së;
- b) kryejnë inspektime në terren për veprimtarinë e shoqërive të sigurisë fizike dhe qendrave të trajnimit të punonjësve të SHPSF-së.
- c) kryejnë inspektime për mënyrën e kryerjes së detyrës nga punonjësit e këtij shërbimi;
- ç) kryejnë inspektime për kriteret e mbajtjes dhe përdorimit të armëve, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) kryejnë inspektime për mbajtjen e uniformës, mjeteve lëvizëse, si dhe mjeteve të tjera në përdorim, sipas përcaktimeve në këtë ligj;
- dh) bëjnë identifikimin e shkeljeve të rregullave të shërbimit, mbajnë procesverbal konstatimi, ndjekin procedurat për marrjen e masave administrative.

2. Përcaktimi i kompetencave midis strukturave qendrore e vendore të Policisë së Shtetit apo dhe midis funksioneve policore bëhet me udhëzim të ministrit.

Neni 21

Dokumenti i identifikimit

1. Subjekti i SHPSF-së ka për detyrë të pajisë çdo punonjës të shërbimit me dokument identifikimi.
2. Punonjësi i shërbimit ka për detyrë ta mbajë dokumentin e identifikimit në vend të dukshëm vetëm gjatë kryerjes së detyrës dhe ta paraqesë atë sa herë i kërkohet për identifikim.
3. Pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës me subjektin, punonjësi i shërbimit detyrohet të dorëzojë dokumentin e identifikimit.

4. Forma dhe përmbajtja e dokumentit të identifikimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Neni 22

Menaxhimi i shërbimit të SHPSF-së

(ndryshuar neni me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Për menaxhimin e shërbimit të SHPSF-së subjekti i licencuar duhet të plotësojë këto kushte:
 - a) të ngrejë strukturën e QMSH-së për nënkategorinë ose nënkategoritë përkatëse, e cila miratohet para fillimit të aktivitetit nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit.
 - b) të ngrejë zyrën e menaxhimit të shërbimit në qarkun ku ushtron aktivitetin e SHPSF-së, e cila miratohet para fillimit të aktivitetit nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit.
2. Procedurat e miratimit, funksionimit, standardet e Qendrës së Menaxhimit të Shërbimit dhe Zyrës së Menaxhimit të Shërbimit të SHPSF-së përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 23

Uniforma e punonjësit të shërbimit të SHPSF-së

1. Uniforma e punonjësit të shërbimit të SHPSF-së mbahet dhe përdoret vetëm gjatë kryerjes së shërbimit.
2. Në uniformë duhet të vendosen, sipas përkatësisë, shenjat dalluese, emblemat, stemat, numri identifikues, të cilat tregojnë identitetin e subjektit dhe të punonjësit të shërbimit.
3. Uniforma dhe elementet përbërëse të saj nuk duhet të jenë të ngjashme me strukturat e Policisë së Shtetit, të Forcave të Armatosura dhe të agjencive të tjera ligjzbatuese shtetërore, të krijuara sipas legjislacionit në fuqi.
4. Pjesët përbërëse të uniformës, paraqitja e jashtme e punonjësit të shërbimit, gjatë kryerjes së detyrës, mjetet sinjalizuese, pamore/zanore, vendosja dhe përdorimi i tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit.

KREU IV

FUNKSIONET, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 24

Përgjegjësitë e titullarit të subjektit të SHPSF-së

(ndryshuar shkronjat a, k, ll dhe m; shfuqizuar shkronjat c dhe f; shtuar shkronjat n, nj, o, p dhe q me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

Titullari i SHPSF-së është përfaqësuesi ligjor i subjektit të licencuar që ofron shërbimin për sigurimin fizik të objekteve shtetërore e private, të personave, të veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike, si dhe për sigurimin e vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, të kontraktuara, dhe ka këto përgjegjësi:

- a) të marrë masa për zhvillimin e aktivitetit për të cilin është licencuar, në përputhje me kushtet e kriteret e vendosura në këtë ligj;
- b) të shlyejë të gjitha detyrimet financiare ndaj shtetit, ato kontraktuale, si dhe ndaj punonjësve të SHPSF-së;
- c) Shfuqizuar
- ç) të aplikojë për ripërtëritje certifikate, në Policinë e Shtetit, 90 ditë para datës së përfundimit të afatit;
- d) të informojë në kohë strukturat e Policisë së Shtetit, si dhe të sigurojë bashkëpunimin e

vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me sigurinë publike në territorin e objektit në ruajtje;

dh) të vërë në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit, sa herë që kërkohet, punonjësit e shërbimit dhe mjetet e transportit, në rastet e ngjarjeve kriminale, cenimeve të sigurisë publike, emergjencave civile, pa shpërblim financiar;

e) të informojë, me shkrim, të paktën një herë në muaj, në strukturën përkatëse të Policisë së Shtetit, për veprimtarinë e SHPSF-së;

ë) të mbajë dokumentacionin e miratuar për veprimtarinë e SHPSF-së;

f) Shfuqizuar

g) të marrë masat e nevojshme për sigurimin teknik në lidhje me armët dhe municionet, mjetet e shërbimit, sipas legjislacionit në fuqi;

gj) të përmbushë dhe të organizojë punën për realizimin e detyrave të lëna në aktkontrolle gjatë inspektimeve nga çdo agjenci ligjzbatuese;

h) të respektojë liritë e të drejtat e njeriut në hapësirat dhe territoret publike;

i) të mos punësojë në veprimtarinë e SHPSF-së punonjës shërbimi të pacertifikuar;

j) të zbatojë kriteret e rekrutimit dhe të trajtimit në mënyrë të njëjtë për shtetasit, pa i diskriminuar ata në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit, etnisë, bindjeve politike, fetare e filozofike, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, në përputhje me ligjin në fuqi;

k) të njoftojë menjëherë Policinë e Shtetit për çdo ngjarje të ndodhur gjatë kryerjes së veprimtarisë;

l) të përdorë aktivitetin e SHPSF-së vetëm për qëllimin për të cilin është licencuar;

ll) titullari i një subjekti të SHPSF-së nuk mund të jetë titullar i më shumë se një subjekti të SHPSF-së;

m) të njoftojë menjëherë strukturën e policisë kur bëhet largimi i drejtuesit teknik, si dhe të aplikojë për zëvendësimin e tij brenda 15 ditëve. Kompetencat në mungesë i kalojnë përkohësisht përgjegjësit të shërbimit me urdhër të titullarit të subjektit deri në miratimin e drejtuesit teknik.

n) zbaton detyrimet kontraktuale në lidhje me numrin e vendrojave, numrin e punonjësve për çdo vendroje, grupet verifikuese, si dhe për pajisjet sinjalizuese alarmi, kamera sigurie ose qen shërbimi;

nj) njofton Policinë e Shtetit brenda 10 ditëve për çregjistrimin e subjektit, si dhe për çdo ndryshim faktik të të dhënave të veprimtarisë së tij;

o) njofton Policinë e Shtetit për ndryshimet faktike, të cilat kanë të bëjnë me kriteret e licencimit;

p) njofton menjëherë Policinë e Shtetit për lidhjen e kontratave të reja, si dhe për çdo ndryshim që pëson kontrata e lidhur që ka të bëjë me aftësinë e sigurisë fizike të objektit dhe brenda 30 ditëve dorëzon kopje të saj në strukturat vendore të policisë. Lidhur me detyrimin për njoftimin për kontratat e reja, subjekti i SHPSF-së ruan të drejtën për të mos njoftuar strukturën vendore për çmimin e kontratës së lidhur;

q) ruan dokumentacionin e aktivitetit të subjektit në arkiv sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat".

"Neni 24/1

Titullari i Qendrës së Trajnimit Privat

(shtuar me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Titullari i Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-së është përfaqësuesi ligjor i subjektit të licencuar dhe kryen këto detyra:

a) merr masa për zhvillimin e aktivitetit për të cilin është licencuar, në përputhje me kushtet e kriteret e vendosura në këtë ligj;

- b) trajnon dhe pajis me certifikatë punonjësit e shërbimit, që kryejnë kursin e plotë të trajnimit dhe që shpallen fitues në testimin përfundimtar sipas programit të miratuar;
 - c) lidh kontrata individuale pune me trajnerët e certifikuar për trajnime në fushën e SHPSF-ve;
 - ç) aplikon për ripërtëritjen e certifikatës jo më vonë se 90 ditë para përfundimit të afatit;
 - d) informon çdo 3 muaj strukturat e Policisë së Shtetit për veprimtarinë e QTP-së;
 - dh) ruan dokumentacionin e aktivitetit të subjektit në arkiv sipas rregullave të përcaktuara në ligjin përkatës;
 - e) punëson në veprimtarinë e QTP-së vetëm trajnerë të certifikuar për trajnime në fushën e SHPSF-ve;
 - ë) njofton menjëherë strukturën e policisë kur bëhet largimi i drejtuesit teknik dhe për çdo trajner, si dhe brenda 15 ditëve duhet të aplikojë për zëvendësimin e tyre;
 - f) njofton Policinë e Shtetit brenda 10 ditëve për çregjistrimin e subjektit;
 - g) njofton Policinë e Shtetit për ndryshimet që ka bërë në QKB, të cilat kanë të bëjnë me kriteret e licencimit;
 - gj) përdor aktivitetin e qendrës vetëm për qëllimin për të cilin është licencuar.
2. Titullari i një subjekti QTP nuk mund të jetë titullar i më shumë se një subjekti të QTP-së.

Neni 25

Drejtuesi teknik

(ndryshuar pika 1; shtuar e ndryshuar togfjalësh në pikën 4 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Drejtuesi teknik i SHPSF-së dhe QTP-së është drejtuesi më i lartë teknik për drejtimin, menaxhimin dhe kontrollin e veprimtarisë.
2. Marrëdhëniet ndërmjet titullarit të subjektit me drejtuesin teknik, rregullohen sipas legjislacionit në fuqi.
3. Në çdo rast të largimit të drejtuesit teknik, titullari i subjektit të SHPSF-së njofton menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe, brenda 15 ditëve, duhet të aplikojë për certifikimin e tij.
4. Subjekti i licencuar i SHPSF-së dhe QTP-së aplikon në QKB për ndryshimin e drejtuesit teknik, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

Neni 26

Përgjegjësitë e drejtuesit teknik

(ndryshuar me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Drejtuesi teknik i nënkategorive 1.3.A, 1.3.B dhe 1.3.C është përgjegjës për drejtimin, menaxhimin, kontrollin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe të veprimtarisë së subjektit.
2. Drejtuesi teknik i SHPSF-së kryen këto detyra:
 - a) asiston për aspekte teknike titullarin e SHPSF-së në nënshkrimin e marrëveshjes apo kontratës me palën kontraktuese për objektin që merr në ruajtje shoqëria;
 - b) harton rregullat e funksionimit të veprimtarisë sipas nënkategorive të licencave të përfituara;
 - c) është përgjegjës për njohjen e punonjësve vartës me legjislacionin përkatës dhe për organizimin e trajnimit të tyre;
 - ç) përpilon plandislokimet me skemat e ruajtjes për çdo objekt në ruajtje dhe për situata emergjente parashikon plane të veçanta;

d) është përgjegjës për informimin në kohë të strukturave të Policisë së Shtetit për çdo ngjarje të ndodhur, si dhe siguron bashkëpunimin e vazhdueshëm për probleme që lidhen me sigurinë e objektit në ruajtje dhe për situata emergjente planifikon plane të veçanta;

dh) është përgjegjës për planifikimin, organizimin, menaxhimin, kontrollin, inspektimin, përpilimin e dokumentacionit, sigurimin e armatimit dhe të pajisjeve përkatëse të shërbimit të sigurisë fizike;

e) harton planin e masave për aktivitetet sportive dhe aktivitete të tjera, të cilin e dërgon për vlerësim paraprak në komisariatit e policisë në territorin e të cilit zhvillohet aktiviteti, si dhe është përgjegjës për marrjen e masave të sigurisë në mjediset përkatëse;

ë) ka përgjegjësinë të konstatojë dhe të analizojë të metat e dobësitë e punonjësit të shërbimit, t'ua bëjë ato të njohura administratorit dhe strukturave vendore të Policisë së Shtetit, si dhe të marrë masa për shmangien dhe përmirësimin e tyre;

f) jep masa disiplinore ndaj punonjësit të shërbimit sipas kuptimit të këtij ligji;

g) zbaton detyrimet ligjore për planifikimin e trajnimeve, njoftimin e punonjësve dhe mundësimin e pjesëmarrjes së tyre në trajnim;

gj) parandalon planifikimin në shërbim të punonjësit të papajisur me uniformë, armatim dhe pajisje shërbimi;

h) merr masa për ruajtjen e vendit të ngjarjes në rastin kur ndodh një vepër penale në territorin e objektit që ka në ruajtje, duke njoftuar Policinë e Shtetit dhe duke bashkëpunuar me të;

i) aplikon për ripërtëritje certifikate në Policinë e Shtetit 90 ditë para datës së përfundimit të afatit.

3. Drejtuesi teknik i QTP-së kryen këto detyra:

a) harton rregullat e funksionimit të veprimtarisë sipas nënkategorisë së licencës të përfituar;

b) është përgjegjës për njohjen e punonjësve vartës me legjislacionin përkatës dhe për organizimin e trajnimit të tyre;

c) zbaton detyrimet ligjore për planifikimin e trajnimeve, njoftimin e punonjësve dhe mundësimin e pjesëmarrjes së tyre në trajnim;

ç) aplikon për ripërtëritje certifikate në Policinë e Shtetit 90 ditë para datës së përfundimit të afatit.

Neni 26/1

Përgjegjësi i shërbimit

(shtuar me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Përgjegjësi i shërbimit është punonjësi i shërbimit i caktuar në detyrë nga titullari i subjektit të SHPSF-së dhe është në varësi të drejtpërdrejtë të drejtuesit teknik, i cili merret me planifikimin, organizimin dhe kontrollin e shërbimit për një objekt ose disa objekte të caktuara dhe kryen këto detyra:

a) është përgjegjës për planifikimin, organizimin dhe kontrollin e shërbimit në një objekt ose disa objekte të caktuara;

b) planëzon shërbimet për ruajtjen e objektit, personit fizik apo shoqërimin e vlerave monetare në lëvizje;

c) merr masa dhe parandalon planëzimin në shërbim të punonjësve të shërbimit pa uniformë, armatim dhe pajisje shërbimi;

ç) mban sipas rregullores armatimin personal, uniformën e shërbimit, simbolet e SHPSF-së, mjetet speciale dhe mjetet e shërbimit dhe t'i përdorë ato vetëm gjatë kryerjes së detyrës;

d) përdor armën sipas legjislacionit në fuqi;

dh) vihet në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit sa herë që kërkohet për parandalimin e veprave penale dhe zbulimin e ngjarjeve të ndodhura në objektet në ruajtje apo që kanë lidhje me detyrën;

e) ka përgjegjësi të konstatojë të metat dhe dobësitë e punonjësve të shërbimit, duke ua bërë të njohura titullarit, drejtuesit teknik dhe strukturave të policisë vendore;

ë) merr masa për ruajtjen e vendit të ngjarjes për rastet kur vepra penale ka ndodhur në territorin e objektit në ruajtje, si dhe njofton Policinë e Shtetit duke bashkëpunuar me strukturat e saj;

f) komunikon me transparencë, etikë dhe në përputhje me kërkesat e akteve ligjore me qytetarët, eprorët dhe me autoritetet ligjzbatuese;

g) nuk përdor mjetet e transportit të caktuara për shërbim për interesa personale, për vete dhe për të tretët;

gj) ruan dhe mirëmban mjetet e ndërlidhjes, të ndriçimit, si dhe pajisjet e tjera të dhëna për përmbushjen e detyrës;

h) ruan cilësitë morale, kodin etik për komunikim dhe sjellje qytetare, si dhe nuk përdor gjatë shërbimit pije alkoolike.

2. Kriteret, standardet dhe procedurat për përzgjedhjen e përgjegjësit të shërbimit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.”.

Neni 27

Përgjegjësitë e punonjësit të shërbimit

(ndryshuar paragrafi i parë me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

Punonjësi i shërbimit privat të sigurisë fizike është punonjës i certifikuar në fushën e shërbimeve të sigurisë fizike dhe ka këto përgjegjësi:

a) të kryejë detyrat e përcaktuara në këtë ligj e në aktet nënligjore, si dhe detyrat e dhëna nga drejtuesi teknik i subjektit;

b) të zbatojë me korrektësi detyrat për ruajtjen e objektit dhe të mbajë lidhje të vazhdueshme me drejtuesin teknik;

c) të mbajë, sipas rregullores, armatimin personal e pajisjet e shërbimit, të përdorë uniformën, shenjat dhe simbolet e SHPSF-së, vetëm gjatë kryerjes së detyrës, si dhe të përdorë armën sipas legjislacionit në fuqi;

ç) të kryejë detyrat për ruajtjet e vendit të ngjarjes në territorin e shërbimit, të bëjë identifikimin e personave që lidhen me ngjarjen dhe të vihet në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit për hetimin e ngjarjes në objektin që siguron;

d) të japë informacionin e mundshëm në funksion të kryerjes së detyrave të Policisë së Shtetit;

dh) të vihet në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit, sa herë që kërkohet, për parandalimin e veprave penale dhe zbulimin e ngjarjeve të ndodhura në mjedisin ku kryen detyrën ose në ato të lidhura me detyrën;

e) të komunikojë me transparencë, etikë dhe konform kërkesave të ligjit me qytetarët, eprorët dhe me çdo autoritet ligjzbatues, kur kërkohet një gjë e tillë;

ë) të mos përdorë mjetet e transportit, të dhëna për shërbim, për interesa personale, për vete dhe për të tretët;

f) të ruajë e të mirëmbajë mjetet e ndërlidhjes e ndriçimit, si dhe pajisjet e tjera të dhëna për përmbushjen e detyrës;

g) të plotësojë detyrimet financiare që vijnë nga masat administrative;

gj) të mos vendosë në uniformë dhe në mjetet e transportit simbole apo shenja të tjera, përveç atyre të miratuara nga ky ligj;

h) të ruajë cilësitë morale, kodin etik për komunikim dhe sjellje qytetare, si dhe të mos përdorë pije

alkoolike, droga e lëndë narkotike në shërbim.

Neni 28

Verifikimi i besueshmërisë

(ndryshuar pika 1 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Verifikimi i besueshmërisë për personat që aplikojnë për titullar subjekti dhe drejtues teknik të SHPSF-së dhe QTP-së, për punonjës shërbimi të SHPSF-së dhe për trajner të QTP-së kryhet nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit në raport me të dhënat e regjistrave fizikë e elektronikë në administrim të Policisë së Shtetit dhe në regjistrat fizikë e elektronikë tek të cilat Policia e Shtetit ka akses.

2. Forma dhe përmbajtja e formularit të besueshmërisë përcaktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Neni 29

Trajnimet për punonjësit e SHPSF-së

(shtuar pika 1/1; shfuqizuar pika 2 dhe ndryshuar pika 4 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Trajnimet për punonjësit e shërbimit në veprimtarinë e SHPSF-së bëhen në institucionin arsimor policor përkatës dhe në qendrat e trajnimit privat, bazuar në programet e miratuara nga qendra e arsimit policor.

1/1. Trajnimet e punonjësve të SHPSF-së në Qendrën e Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-së kryhen nga trajneri i certifikuar nga institucioni arsimor policor sipas programit të miratuar të trajnimit. Trajneri i QTP-së duhet të jetë me arsim të lartë dhe të ketë mbi 5 vjet përvojë pune në institucionet shtetërore të sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe të mos jetë shkarkuar nga detyra për shkaqe disiplinore në 3 vjetët e fundit nga koha e kërkesës.

2. Shfuqizuar

3. Programet, afati i trajnimit, kushtet dhe kriteret për ndjekjen e trajnimit, që kërkohen në raste të tilla, miratohen nga institucioni arsimor policor.

4. Procedurat për miratimin e programeve, certifikimin e trajnerit për Qendrën e Trajnimit të Punonjësve të SHPSF-së dhe përgjegjësitë e tij përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

5. Pas 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të fillojnë procedurat e trajnimit për punonjësit e shërbimit privat të sigurisë fizike, sipas pikës 4 të këtij neni.

Neni 30

Konflikti i interesit

(ndryshuar tofjalësh në pikën 1; shtuar tofjalësh në pikën 2 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Titullari dhe drejtuesi teknik i SHPSF-së dhe QTP-së, si dhe punonjësi i shërbimit të SHPSF-së nuk mund të jetë njëkohësisht punonjës i strukturave të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, ushtarak i Forcave të Armatosura, punonjës i Shërbimit Informativ të Shtetit si dhe punonjës i Policisë së Burgjeve.

2. Titullari i SHPSF-së dhe QTP-së nuk duhet të ketë lidhje interesi, pasurore, ose vetjake jo pasurore me zyrtarin, i cili certifikon ose licencon veprimtarinë e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike.

Neni 31

Administrimi i të dhënave

(shtuar togfjalësh në pikat 1 dhe 3 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Subjektet e licencuara të SHPSF-së dhe QTP-së detyrohen, sipas këtij ligji, të mbajnë e të administrojnë të dhënat dhe treguesit kryesorë të veprimtarisë të së tyre.
2. Subjektet e licencuara duhet të sigurohen që përpunimi i të dhënave është në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Subjektet e SHPSF-së dhe QTP-së janë të detyruara të japin çdo informacion të administruar në bazën e të dhënave të tyre kur ato kërkohen nga Policia e Shtetit, organet e prokurorisë dhe të gjykatës, si dhe nga çdo agjenci ligjzbatuese publike, në përputhje me qëllimin e përpunimit.

Neni 32

Pajisjet për shërbimin e sigurinë private

(ndryshuar pika 2 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Subjektet e licencuara janë të detyruara të përdorin mjete dhe pajisje elektronike në veprimtarinë e sigurisë fizike.
2. Të dhënat e siguruar nga përdorimi i këtyre pajisjeve trajtohen sipas kërkesave të legjislacionit për masat shitesë të sigurisë publike dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
3. Pajisjet dhe të dhënat e siguruar nga përdorimi i tyre vihen në dispozicion sa herë që kërkohen nga Policia e Shtetit, organet e prokurorisë, në përputhje me qëllimin e përpunimit, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 33

Përdorimi i forcës

1. Punonjësi i shërbimit i SHPSF-së përdor forcën fizike dhe pajisjet e mjetet e tjera, të dhëna për përmbushjen e detyrës, vetëm kur kjo është e nevojshme dhe nëse masat e tjera nuk kanë dhënë rezultat, në përputhje me kriteret e përshkallëzimit të saj.
2. Punonjësi i shërbimit përshkallëzon nivelin e nevojshëm të përdorimit të forcës, duke filluar nga bindja me fjalë, shtrëngimi fizik, deri te shkopi i gomës.
3. Punonjësi i shërbimit duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj.
4. Të dëmtuarit nga përdorimi i forcës i jepet ndihma e parë mjekësore, në rast se kjo është e nevojshme dhe e mundshme.
5. Struktura e policisë vendore duhet të vihet në dijeni për çdo rast të përdorimit të forcës.

Neni 34

E drejta e mbajtjes së armëve të zjarrit dhe municionit

(ndryshuar pika 1 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Në veprimtarinë e sigurisë fizike të drejtën e mbajtjes së armëve të zjarrit dhe municionit e kanë drejtuesi teknik dhe punonjësit e shërbimit të pajisur me autorizim përkatës nga Policia e Shtetit, sipas kërkesave të ligjit nr. 74/2014, "Për armët", të ndryshuar, dhe që është:
 - a) autorizimi për mbajtje arme në shërbim, që nënkupton të drejtën e drejtuesit teknik dhe punonjësit të shërbimit për mbajtjen e armës gjatë kohës së punës, vetëm në ambientet e punës apo të shërbimit;

b) autorizimi për mbajtje arme në lëvizje, që nënkupton të drejtën e punonjësit të shërbimit, trupprojës për mbajtjen e armës vetëm gjatë kryerjes së detyrës, edhe jashtë qendrës së banimit apo të punës/shërbimit.

2. Lloji i armëve të zjarrit dhe municionit të tyre që jepen për mbajtje miratohen nga Policia e Shtetit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Neni 35

Përdorimi i armës së zjarrit

1. Punonjësi i shërbimit, vetëm gjatë kryerjes së detyrës të SHPSF-së, e përdor armën e zjarrit në kushtet e mbrojtjes së nevojshme dhe të nevojës ekstreme.

2. Titullari i subjektit, drejtuesi teknik, punonjësi i shërbimit, janë të detyruar të njoftojnë menjëherë në Policinë e Shtetit për përdorimin e armës së zjarrit dhe të mos largohen nga detyra.

Neni 36

Qentë e shërbimit

1. Subjekti i SHPSF-së ka të drejtën të mbajë dhe të përdorë qentë e shërbimit, të certifikuar nga Instituti i Përgatitjes së Qenve, vetëm për nevoja të shërbimit.

2. Kushtet për mbajtjen e përdorimin e qenve të shërbimit përcaktohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Neni 37

Pajisjet e shërbimit

(ndryshuar me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Subjekti i SHPSF-së për realizimin e shërbimit vë në dispozicion të punonjësve të shërbimit mjete e pajisje shërbimi të pajisura me autorizim nga Drejtoria Vendore e Policisë. Për realizimin e shërbimit të transportit të vlerave monetare, sendeve të çmuara dhe shërbimit të ruajtjes së afërt/truprojë të personave fizikë/juridikë, subjektet përdorin automjete të blinduara sipas standardeve evropiane të pajisura me autorizim me afat 5-vjeçar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Ndalohet dhënia me qira, huapërdorja dhe nënkontraktimi i mjeteve të blinduara për personat fizikë e juridikë.

2. Lloji i mjeteve, pajisjeve, automjeteve të shërbimit, automjeteve të blinduara, si dhe mënyra e lëshimit të autorizimit për automjetet e blinduara përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë.

KREU V

MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 38

Kundërvajtjet administrative

(shfuqizuar pika 4 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Për shkelje të dispozitave të këtij ligji, kur ato nuk përbëjnë vepër penale, jepen masa administrative.

2. Konstatimi, shqyrtimi dhe gjykimi i shkeljeve bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Masat administrative jepen nga strukturat e Policisë së Shtetit.

4. Shfuqizuar

Neni 39

Llojet e masave administrative

(ndryshuar neni me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Për shkeljet e dispozitave të këtij ligji jepen përkatësisht këto lloj masash administrative:

a) për subjektin e licencuar të SHPSF-së dhe QTP-së:

i. vërejtje;

ii. vërejtje me paralajmërim për heqje licence;

iii. gjobë;

iv. heqje e licencës.

b) për titullarin e subjektit dhe drejtuesin teknik të SHPSF-së dhe QTP-së:

i. vërejtje;

ii. vërejtje me paralajmërim për heqje certifikate;

iii. heqje e certifikatës.

c) për punonjësën e shërbimit dhe përgjegjësin e shërbimit të SHPSF-së:

i. vërejtje;

ii. vërejtje me paralajmërim për heqje certifikate;

iii. heqje e certifikatës.

2. Masa “vërejtje” jepet në këto raste:

a) sjellja e parregullt gjatë kohës së punës me eprorët, kolegët dhe me publikun;

b) mosbindja ndaj urdhrave të eprorëve;

c) shkelja e rregullave të etikës në punë;

ç) mbajtja e papërshtatshme e uniformës gjatë shërbimit;

d) keqpërdorimi i autorizimit gjatë kryerjes së detyrës kur nuk ka sjellë pasoja të rënda;

dh) kryerja e veprimeve që cenojnë punëdhënësin gjatë dhe jashtë orarit të punës.

3. Masa “vërejtje me paralajmërim për heqje certifikate” është shkelje e lehtë disiplinore dhe jepet në këto raste:

a) mospërmbyllja e detyrave;

b) mosbindja ndaj urdhrave të eprorëve, e kryer më shumë se një herë;

c) shkelja e përsëritur e rregullave të etikës në punë;

ç) keqpërdorimi i autorizimit gjatë kryerjes së detyrës kur ka sjellë pasoja të rënda;

d) braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar në punë kur mungesa ka sjellë pasoja të rënda.

4. Masa “vërejtje me paralajmërim për heqje licence” jepet ndaj subjektit në këto raste:

a) moszbatimi i parashikimeve të pikës 1 të nenit 34 kur është konstatuar më shumë se një herë;

b) shkelja e parashikimeve të pikës 3 të nenit 23 kur është konstatuar më shumë se një herë;

c) shkelja për rastet e parashikuara në nenin 40, pika 1, shkronjat “ç”, “dh”, “e” dhe “ë” nga ana e titullarit të subjektit kur nuk janë shkaktuar pasoja të rënda.

Neni 40

Heqja e licencës për subjektin e SHPSF-së dhe QTP-së

(ndryshuar togfjalësh në shkronjën g dhe gj* të pikës 1 dhe shkronja ç; shtuar togfjalësh në titull, në paragrafin e 1 dhe pika 3; shfuqizuar shkronja f; shtuar shkronjat h dhe i me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)*

1. Subjektit të SHPSF-së dhe QTP-së i hiqet licenca në këto raste:

- a) kur vërtetohet se përdoret në kundërshtim me kushtet dhe kriteret e vendosura në këtë ligj;
 - b) me kërkesën e vetë subjektit;
 - c) kur është marrë vendim i formës së prerë nga gjykata, si masë penale plotësuese;
 - ç) kur është dënuar administrativisht me masën “gjobë” ose “vërejtje me paralajmërim për heqje licence” për të njëjtën shkelje më shumë se dy herë brenda vitit kalendarik.
 - d) me heqjen e certifikatës së titullarit të subjektit të SHPSF-së dhe QTP-së licenca e humbet vlefshmërinë;
 - dh) kur veprimtaria e subjektit të SHPSF-së dhe QTP-së ushtrohet pa drejtues teknik të certifikuar, sipas kërkesave të këtij ligji;
 - e) kur punëson persona të pacertifikuar, sipas kërkesave të këtij ligji;
 - ë) kur ushtron veprimtari të SHPSF-së dhe QTP-së të padeklaruar më parë, sipas kërkesave të këtij ligji;
 - f) Shfuqizuar.
 - g) kur nuk njofton brenda 10 ditëve strukturat e Policisë së Shtetit dhe QKB-në për ndërprerjen e aktivitetit të shërbimit të SHPSF-së dhe QTP-së;
 - gj) kur nuk njofton organet e Policisë së Shtetit për ndryshimet që ka bërë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe që kanë të bëjnë me kriteret e licencimit.
 - h) kur afati i vlefshmërisë së certifikatës së titullarit ka përfunduar dhe ai nuk ka aplikuar brenda afateve ligjore për certifikim, konsiderohet se aktiviteti ushtrohet pa titullar subjekti të certifikuar.
 - i) kur afati i vlefshmërisë së certifikatës së drejtuesit teknik ka përfunduar dhe ai nuk ka aplikuar brenda afateve ligjore për certifikim, konsiderohet se aktiviteti ushtrohet pa drejtues teknik të certifikuar.
2. Vendimi për heqjen e licencës publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.
3. Masa administrative me gjobë e vendosur sipas shkronjës “ç” të pikës 1 të këtij neni nuk aplikohet për shkeljet e punonjësve të shërbimit dhe përgjegjësit të shërbimit.

Neni 41

Heqja e certifikatës së titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik

(ndryshuar shkronja ç dhe shtuar shkronja ç/1 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Masa administrative “Heqje e certifikatës së titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik” jepet në këto raste:
- a) kur humbasin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj;
 - b) me kërkesën e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik;
 - c) kur është marrë vendim i formës së prerë nga gjykata, si masë penale plotësuese;
 - ç) kur titullari i subjektit është dënuar administrativisht me masën “vërejtje me paralajmërim për heqje licence” apo “gjobë” për të njëjtën shkelje më shumë se dy herë brenda vitit kalendarik.
 - ç/1) kur drejtuesi teknik është dënuar administrativisht me masën “vërejtje” apo me masën “vërejtje me paralajmërim për heqje certifikate” për të njëjtën shkelje më shumë se dy herë brenda vitit kalendarik.
 - d) kur konstatohen shkelje që janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për armët dhe përdorimin e armëve të zjarrit;
2. Heqja e certifikatës bëhet me vendim të arsyetuar të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

Neni 42

Heqja e certifikatës së punonjësit të shërbimit

(ndryshuar shkronja c dhe d me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

Heqja e certifikatës i jepet punonjësit të shërbimit në rastet e mëposhtme:

- a) kur humbasin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj;
- b) kur ai bën kërkesë për heqjen e certifikatës;
- c) me propozim të arsyetuar të drejtuesit teknik të subjektit.
- ç) kur është marrë vendim i formës së prerë nga gjykata, si masë penale plotësuese;
- d) kur është dënuar administrativisht me masën “vërejtje” apo me masën “vërejtje me paralajmërim për heqje certifikate” për të njëjtën shkelje më shumë se dy herë brenda vitit kalendarik.
- dh) kur konstatohen shkelje që bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për armët dhe përdorimin e armëve të zjarrit;
- e) me vendim të arsyetuar të drejtorit të policisë së qarkut.

Neni 43

E drejta për t’u ripajisur me licencë/certifikatë

(shtuar togfjalësh në pikën 1, 2 dhe 3 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Personit juridik, të cilit i është hequr licenca e SHPSF-së, ose QTP-së i lind e drejta të aplikojë për t’u pajisur me licencë të re për SHPSF, ose për QTP-në pas kalimit të afatit trevjeçar.
2. Personit, të cilit i është hequr certifikata për titullar subjekti, i lind e drejta të aplikojë për t’u pajisur me certifikatë të re për SHPSF, ose QTP pas kalimit të afatit trevjeçar.
3. Personit, të cilit i është hequr certifikata për drejtues teknik, i lind e drejta të aplikojë për t’u pajisur me certifikatë të re për SHPSF, ose QTP pas kalimit të afatit dyvjeçar.
4. Personit, të cilit i është hequr certifikata për punonjës shërbimi, i lind e drejta e aplikimit për t’u pajisur me certifikatë të re për SHPSF pas kalimit të afatit njëvjeçar, duke iu nënshtruar kriterëve të këtij ligji.

Neni 44

Gjobat për subjektin e licencuar

(ndryshuar pikat 1, 2 dhe 3; shtuar pikat 3/1 dhe 3/2; shfuqizuar pikat 4 dhe 5 me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

Kur shkeljet e subjektit të licencuar nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë shkelje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

1. Për shkeljet e konstatuara për moszbatim të kërkesave të nenit 24, shkronjat “d”, “dh”, “g”, “m”, “n”, “nj”, “o”, “p”, “q”, nenit 24/1, shkronjat “c”, “e”, “f” dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri 100 000 (njëqind mijë) lekë.
2. Për shkeljet e konstatuara për moszbatim të kërkesave të neneve 25, pika 3, dhe 29, pika 1, të këtij ligji dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 300 000 (treqind mijë) lekë.
3. Për shkeljet e konstatuara ndaj drejtuesit teknik, të parashikuara nga neni 26, shkronjat “b”, “ç”, “d”, “dh”, “g”, “gj”, “h” subjekti dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

3/1. Për shkeljet e konstatuara ndaj përgjegjësit të shërbimit, të parashikuara nga neni 26/1, shkronjat “a”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “g” subjekti dënohet me gjobë në masën nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

3/2. Për shkeljet e konstatuara ndaj punonjësit të shërbimit, të parashikuara nga neni 23, pikat 1 dhe 2, neni 27, neni 33, pika 1, neni 34, pika 1, subjekti dënohet me gjobë në masën nga 5 000 (pesë mijë) deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë.

4. Shfuqizuar.

5. Shfuqizuar.

6. Të ardhurat nga këto gjoba derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 45

Masa administrative për drejtuesin teknik

(ndryshuar neni me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

Për shkeljet e konstatuara për moszbatim të kërkesave të këtij ligji, sipas nenit 26, pika 2, shkronjat “b”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”, “h”, e pika 3, shkronja “c”, nenit 32, pika 2, dhe nenit 33, pika 5, drejtuesit teknik i jepet masë administrative “vërejtje” ose “vërejtje me paralajmërim për heqje certifikate.”

Neni 45/1

Masa administrative për përgjegjësin e shërbimit

(shtuar me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

Për shkeljet e konstatuara për moszbatim të kërkesave të këtij ligji, sipas nenit 26/1, shkronjat “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “gj”, përgjegjësi i shërbimit dënohet me masën “vërejtje” ose “vërejtje me paralajmërim për heqje certifikate.”.

“Neni 46

Masa administrative për punonjësin e shërbimit

(ndryshuar me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

Për shkeljet e konstatuara për moszbatim të kërkesave të neneve 23, pikat 1 dhe 2, 27, 33, pikat 1 e 5, 34, pika 1, të këtij ligji, punonjësi i shërbimit dënohet me masën “vërejtje” ose “vërejtje me paralajmërim për heqje certifikate.”

Neni 47

Kompetenca e dhënies së masave

(ndryshuar me Ligjin nr. 90/2023, datë 2.11.2023)

1. Dhënia e masave administrative sipas neneve 44, 45 dhe 45/1 të këtij ligji është kompetencë e drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë ose drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit mbi bazën e konstatimeve të shkeljeve gjatë inspektimeve të kryera nga strukturat vendore ose qendrore.

2. Dhënia e masave administrative sipas neneve 42 dhe 46 është kompetencë e drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë.

3. Dhënia e masave administrative sipas nenit 39, pika 1, shkronja “a”, nënndarjet “i” dhe “ii”, dhe “b”, nënndarjet “i” dhe “ii”; neneve 40 dhe 41 të këtij ligji, është kompetencë e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Neni 48

Tarifat financiare

1. Aplikimi për lëshimin e licencave/certifikatave, sipas dispozitave të veçanta të këtij ligji, kryhet kundrejt pagesës së tarifave për shërbimin administrativ.

2. Në rast lëshimi të licencës apo certifikatës, subjekti përkatës paguan tarifën e licencimit/certifikatës në afatin e caktuar nga organi përgjegjës për lëshimin e titullit.

3. Mospagimi i tarifës sjell revokimin e titullit, sipas dispozitave të këtij ligji.

4. Masa, kriteret dhe procedura për tarifat financiare përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe institucioneve përkatëse.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 49

Dispozita kalimtare

Licencat aktive, të dhëna në zbatim të ligjit nr. 8770, datë 19.4.2001, “Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”, të ndryshuar, e ruajnë vlefshmërinë e tyre deri në një 1 vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji, me të drejtën e aplikimit të ri për pajisje me licencë, sipas kushteve dhe kriterëve të këtij ligji.

Neni 50

Aktet nënligjore

1. Ministri i Financave, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr udhëzim të përbashkët me institucionet përkatëse, në zbatim të nenit 48, pika 4.

2. Ministri, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 6; 20, pika 2; 21, pika 4; 23, pika 4; 29, pika 4; 37, pika 2, dhe 38, pika 4, të këtij ligji.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr urdhrat në zbatim të neneve 28, pika 2, dhe 36, pika 2, të këtij ligji.

Neni 51

Dispozita përfundimtare

Ligji nr. 8770, datë 19.4.2001, “Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 52

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.7.2014

Shpallur me dekretin nr. 8651, datë 30.7.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani